

NGJARJET JURIDIKE, TETOR - DHJETOR 2009

STABILITETI FINANCIAR

Në datën 14.10.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 72, deklaratën "Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri për gjashtëmuorin e parë të vitit 2009". Në deklaratë konstatohet se, nën ndikimin e efekteve të krizës financiare ndërkombëtare dhe si rezultat i rënies së depozitave në banka dhe rritjes së kërkesës për borxh nga ana e qeverisë, sektori bankar në vend tkurri vëllimin e financimit për ekonominë e vendit në përgjigje të kërkesës së rritur për likuiditet. Gjatë këtij gjashtëmuorin, zhvillimi i sistemit financiar në vend u ndikua prej ndalesës së rritjes së sektorit bankar, ndërsa pjesa tjetër e tregut financiar ka shënuar një rritje të mirë të veprimtarisë. Sidoqoftë, në fund të kësaj periudhe, sektori bankar shënoi një rezultat financiar pozitiv në vlerën 0.66 miliardë lekë dhe kapitalizimi i veprimtarisë ka mbetur i qëndrueshëm e në nivele të kënaqshme.

POLITIKA MONETARE

Në datën 28.10.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 76 "Për uljen me 0,50 pikë për qind të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes". Përmes uljes me 0.50 pikë përqindje, me një normë bazë interesi që zbret nga 5.75 në 5.25 për qind, Banka e Shqipërisë synon të krijojë premisa për kreditimin e ekonomisë si dhe të vazhdojë procesin e minimizimit të efekteve të krizës financiare ndërkombëtare, duke mbështetur aktivitetin ekonomik të vendit.

MBIKËQYRJA BANKARE

Në datën 14.10.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 71 rregulloren "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit". Rregullorja ka objekt të saj përcaktimin e kërkesave dhe standardeve minimale për administrimin efektiv të rrezikut të likuiditetit nga bankat, përmes ngritjes së një sistemi i cili duhet të përfshijë: strategjinë dhe politikat e hartuara nga banka për administrimin e këtij rreziku; strukturën organizative dhe kontrollin e brendshëm, si dhe planin e emergjencës.

Në datën 11.11.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 78, rritjen e pjesëmarrjes influencuese të Çalik Holding A.S. Turqi (aksioner i tërthortë), nga 25.2 në 45.6 për qind në kapitalin aksioner të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a.

EMISIONI

Në datën 14.12.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 85 "Për tërheqjen nga qarkullimi të disa monedhave me kurs ligjor". Sipas vendimit, kartëmonedha e prerjes 500 Lekë, emetim i vitit 1991, 1992, 1993, 1996, 1997, imazhi lule dielli dhe kartëmonedha e prerjes 500 Lekë, emetim i vitit 1992, 1994, 1996, imazhi i Naim Frashërit, do të kenë kurs ligjor deri në datën 30.06.2010. Këto kartëmonedha do të mblidhen për këmbim kundrejt pagesës së vlerës fillestare të emetimit, me kartëmonedha dhe monedha të tjera me kurs ligjor, deri në datën 31.12.2012.

POLITIKAT EKONOMIKE

Në datën 14.10.2009, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 1011 "Marrëveshjen e grantit PHRD, No. TF 093096, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për përgatitjen e projektit të qeverisjes, financave dhe dhënies së shërbimeve bashkiake". Projekti, për zbatimin e të cilit do të përdoret granti prej nëntëqind e tetëdhjetë mijë dollarësh (980, 000 USD), është faza e parë e një programi afatgjatë për bashkitë në Shqipëri, që synon të arrijë qëndrueshmëri në sigurimin e shërbimeve bashkiake, nëpërmjet forcimit të financave të qeverisjes vendore. Granti do të përdoret për të financuar aktivitete që synojnë të mbështesin dhe përmirësojnë shërbimet e ujërave, kanalizimeve, rrugët lokale, administrimin e mbetjeve inerte, etj.

Në datën 15. 10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 157 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar". Ndryshimet parashikojnë ngritjen e Agjencisë së Koncesioneve, si një institucion publik buxhetor, i ngarkuar me mbikëqyrjen e verifikimin e zbatimit të procedurave të koncesioneve, hetimin administrativ dhe propozimin e masave disiplinore në raste shkeljesh.

Në datën 15.10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 158 "Për obligacionet e shoqërive aksionere dhe të qeverisjes vendore". Ligji përcakton llojet, mënyrat e shpërndarjes dhe maturimin e obligacioneve të emetuara nga shoqëritë aksionere dhe qeveria vendore. Ai rregullon organizimin dhe funksionet e grupit të zotëruesve të obligacioneve, kujdestarit dhe agjentit të zotëruesve të obligacioneve.

Në datën 14.10.2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 1020 "Për krijimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian". Agjencia, e cila ka objektivi të veprimtarisë së saj auditimin dhe kontrollin e zbatimeve të programeve të asistencës të akredituar nga Bashkimi Evropian, është përgjegjëse për funksionimin efikas e të shëndoshë të sistemit të menaxhimit të asistencës dhe funksionalisht e pavarur nga të gjithë aktorët e këtij sistemi.

Në datën 15.10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 10 155 "Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për bashkëpunim në luftën kundër krimit". Përmes kësaj marrëveshjeje, ndër të tjera, të dy vendet angazhohen të bashkëpunojnë më ngushtësisht në luftën kundër formave të ndryshme të krimit financiar si: kontrabandës, pastrimit të parave, falsifikimit dhe shpërndarjes mashtruese të monedhës dhe mjeteve të tjera të pagesës, si dhe akteve kriminale kundër financave publike përfshirë dhe invazionin fiskal.

Në datën 15.10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 10 162 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë për bashkëpunim në luftën kundër krimit". Përmes nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, qeveritë e dy vendeve synojnë të përmirësojnë bashkëpunimin për parandalimin dhe zbulimin e krimit dhe formave të ndryshme të tij si: krimet kundër jetës, terrorizmin dhe financimin e tij, korrupsionin dhe kontrabandën, transaksionet financiare të paligjshme, etj.

Në datën 21.10.2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 1081 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit". Sipas këtij vendimi, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është përgjegjës për planifikimin dhe bashkërendimin e kontrollit zyrtar të ushqimeve, ushqimeve për kafshët, si dhe për mbrojtjen e bimëve në shkallë vendi.

Në datën 22.10. 2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 169 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9482 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar". Ndryshimet përcaktojnë që pagesa e parcelës ndërtimore e ndërtimit pa leje në proces legalizimi mund të bëhet me bono privatizimi, deri në 50 për qind të vlerës së saj. Kjo mënyrë pagese vlen për ndërtesa të ngritura brenda vijës së verdhë, jashtë saj, si dhe në territore të tjera.

Në datën 27.10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi me ligjin nr. 1077, dokumentin strategjik kombëtar "Për hetimin e krimit financiar". Dokumenti synon të krijojë një platformë afatgjatë veprimi dhe të luftojë në mënyrë të pandërprerë krimin ekonomiko-financiar, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, përmes hartimit të legjislacionit me standarde evropiane, rritjes së efektivitetit të kontrollit të zbatimit të këtij legjislacioni dhe rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional.

Në datën 29.10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 180 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për të drejtën e patentave të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale". Përmes këtij ligji, Republika e Shqipërisë aderon në Marrëveshjen e Ligjit për Patentat, miratuar në Gjenevë, më 1 qershor 2000. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje dhe rregullat që dalin prej tyre zbatohen në aplikimet ndërkombëtare për patentat e shpikjes dhe për patentat shtesë, ashtu si dhe për patentat kombëtare dhe rajonale të shpikjeve, për ato kombëtare dhe rajonale shtesë.

Në datën 29. 10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 10 181 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar". Përmes kësaj marrëveshje, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësinë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), Frankfurt mbi Majn, një shumë financimi me vlefë prej shtatë milionë e pesëqind mijë euro (7 500 000 euro) për projektin "Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Shkodrës".

Në datën 29.10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 183 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9374 "Për ndihmën shtetërore". Ky ligj e pasuron ligjin "Për ndihmën shtetërore" me parimet dhe procedurat sipas të cilave lejohet dhe kontrollohet ndihma shtetërore për punonjësit në vështirësi dhe me aftësi të kufizuara, ndihma për mbrojtjen e mjedisit dhe ajo për riskun e kapitalit.

Në datën 29.10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 179 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Patentave Evropiane". Kjo Konventë vendos, për të gjithë shtetet aderues, një sistem ligjor të përbashkët për dhënien e patentave për shpikjet, procedura unike dhe disa rregulla standarde që rregullojnë patentat e dhëna në këtë mënyrë.

Në datën 05.11.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 186 "Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin". Ligji synon të rregullojë marrëdhëniet e pronësisë mbi truallin dhe objektet e ndërtuara në zonat e stimuluar me përparësi turizmin, që janë dhënë për realizimin e veprimtarive të stimuluar, të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Në datën 20.11.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 168 "Për miratimin e formës dhe formulës së privatizimit të INSIG, sh.a.-së". Sipas këtij ligji, forma e transferimit të 100 për qind të aksioneve të shoqërisë tregtare INSIG sh.a., të cilat zotërohen nga shteti shqiptar, është transferimi me anë të shitjes, në favor të investitorëve, nëpërmjet procedurës "Tender i hapur ndërkombëtar".

Në datën 20.11.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 170 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar". Ndryshimet, ndër të tjera, përcaktojnë ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik si organi më i lartë në fushën e prokurimeve publike, i ngarkuar me shqyrtimin e ankesave për procedurat e prokurimit, vendimet e të cilit janë administrativisht përfundimtare.

Në datën 25.11.2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 1151 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë". Sipas këtij vendimi, në njësitë e qeverisjes së përgjithësime do të krijohet fondi i veçantë, me peshë në masën 5% të fondit të përgjithshëm të pagave, i cili do të përdoret për shpërbimin e punonjësve, për dhënie ndihmash të menjëhershme në raste fatkeqësish, etj.

Në datën 25.11.2009, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 1177 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi bashkëpunimin dhe ndihmën reciproke për çështjet doganore". Përmes kësaj marrëveshjeje, dy vendet synojnë që të bëjnë më efektive përpjekjet për të parandaluar shkeljet e legjislacionit doganor dhe për të siguruar mbledhjen e saktë të detyrimeve të import-eksportit, taksave dhe detyrimeve të tjera, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet autoriteteve të tyre doganore.

Në datën 29.11.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10190 "Për buxhetin e vitit 2010". Me një deficit prej afërsisht 50 miliardë lekë, të ardhura që i kalojnë 360 miliardë lekë dhe shpenzime pak më shumë se 410 miliardë lekë, buxheti i vitit 2010 synon të garantojë stabilitetin makroekonomik të vendit dhe rritjen e mëtejshme ekonomike.

Në datën 03.12.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10192 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë". Ligji përcakton procedurat, kompetencat dhe kriteret për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë së personave të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe trafikim. Ai synon parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar përmes konfiskimit të pasurisë së personave të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i pjesëmarrjes në veprimtari kriminale.

Në datën 10.12.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10196 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar". Ndryshimet e parashikuara përmes këtij ligji, prekin kryesisht nenin që rregullon burimet e energjisë së rinovueshme. Kështu, Këshilli i Ministrave autorizohet që të ndërmarrë nisma nxitëse dhe mbështetëse për ndërtimin e centraleve që shfrytëzojnë energjinë e rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike, e cila do të konsumohet tërësisht brenda vendit.

Në datën 10.12.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10197 "Për fondet e pensionit vullnetar". Ligji synon të rregullojë krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e fondeve të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara. Ai vendos standardet e nevojshme për administrimin dhe mbikëqyrjen me efektivitet të këtyre fondeve, duke ngarkuar Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare me përgjegjësinë e ndjekjes së tij.

Në datën 10.12.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10198 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive". Ligji ka për qëllim përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për themelimin, regjistrimin dhe funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, duke bërë të mundur funksionimin e drejtë të tregut të kapitaleve dhe nxitjen e lëvizjes së lirë të tyre. Mbikëqyrja e veprimtarisë së sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të shoqërive administruese, depozitarëve dhe personave të përfshirë në shitjen e kuotave dhe të aksioneve do të realizohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Në datën 15.12.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë miratoi vendimin nr. 100 "Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010". Vendimi përcakton tarifën e shërbimit dhe shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2010, sipas kategorive të konsumatorit. Kështu, çmimi i energjisë elektrike gjatë vitit 2010 për familjarët do të jetë 7.70 lekë/kwh për konsumin deri në 300 kwh, dhe 13.50 lekë/kwh për konsumin mbi 300 kwh.

Në datën 16. 12. 2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 1216 "Për dhënie asistence ekonomike të menjëhershme personave, që përfitojnë pension". Sipas këtij vendimi, personat që përfitojnë pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar, ashtu si dhe ata që trajtohen me shpërblim mujor si veteranë lufte apo trajtim të veçantë financiar, do t'i jepet një asistencë ekonomike e menjëhershme, në shumën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë.

Në datën 23.12.2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 1290 "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe masave të përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural". Përmes këtij vendimi, fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2010 për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në zërin "Transferte në buxhetet familjare" të përdoren për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe të agropërpunimit. Fondet e siguruar synojnë të nxisin mbjelljen e ullishtave, pemëtoreve dhe vreshtave, zbatimin e teknologjive moderne të ujitjes, prodhimin e perimeve në serat diellore, prodhimin e produkteve bio, si dhe rritjen e kreditimit bankar në sektorin e bujqësisë.